



BACHELOR - Udhëzues

mbi konkursin e pranimit

në Akademinë e Filmit & Multimedias Marubi

Kandidatët nga Shqipëria

Kandidatët pasi të kenë verifikuar emrin në listat e shpallura në AFMM (këndi i afishimeve, faqen zyrtare, profilet [Facebook](#) dhe [Instagram](#)), janë të lutur të paraqiten pranë Akademisë Marubi (Adresa: Rr. Aleksandër Moisiu, Nr.78, Kinostudio, në krah të Ministrisë së Kulturës) **për procedurën e regjistrimit në konkurs.**

Për këtë qëllim secili kandidat duhet të ketë patjetër me vete :

1. Dokumentin e identifikimit (kartë identiteti ose pasaportë) ;
2. Të kryejnë pagesën e tarifës së regjistrimit për konkurrim prej 5,000 (pesëmijë) Lekë, pagesë e cila duhet kryer në bankë në llogarinë e Fondacioni Kinostudio me të dhënat si më poshtë:

Union Bank (Lek): AL27 2141 1405 0114 8672 6402 0111

Mbas kryerjes së pagesës, kandidati do të tërheqë pranë zyrës së financës së AFMM faturën tatimore.



Informacion

Akademia e Filmit dhe Multimedias Marubi është institucion i arsimit të lartë me status të veçantë e licencuar që nga 2004 dhe e akredituar nga Ministria e Arsimit që në 2008 dhe në vazhdim. Gjithashtu, është

anëtare me të drejtat të plotë, prej 2008, e Shoqatës Ndërkombëtare e Shkollave të filmit CILECT.

Programi i studimit Bachelor në Film dhe Media zgjasë tre vjet. Viti i parë është i përgjithshëm, viti 2 dhe 3 ndahet sipas profileve duke zgjedhur një nga 4 profile që ofron AFMM: Skenar, Regji, Kamera, ose Montazh. Këto katër profile formojnë të rinj në fushën e Kinematografisë dhe Televizionit, duke i dhënë përparësi jo vetëm formimit teorik por dhe kualifikimit profesional praktik të studentëve duke realizuar filma me metrazh të shkurtër brenda programit të AFMM, me pajisjet të vëna në dispozicion nga shkolla.

Tarifat e studimit në ngarkim të studentit janë:

Viti 1 = 300€ - Viti 2 = 300€ - Viti 3 = 300€

Pagesa bëhet ekskluzivisht përmes bankës.

Në AFMM, aplikojnë Maturantë, sipas datat e publikuara nga Ministria e Arsimit, dhe plotësojnë në sekretarinë e AFMM-së një formulari, dhe dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar.

Pas aplikimit, si dhe pagesës prej 5,000 leke në paraqitjen e dosjes së kandidaturës në sekretarinë e AFMM, ju lind e drejta të hyni në konkursin.

Konkursi konsiston në tre faza:

- test për kulturën e përgjithshme (me gojë - 30 pikë),
- test për kulturën kinematografike (me shkrim - 30 pikë),
- një ushtrim fotografik me 3 foto/story (aparati fotografik mundësohet nga AFMM - 30 pikë)

Pikët minimale që duhet të marrë një kandidat për t'u pranuar si fitues në ciklin e parë të studimeve Bachelor, janë 60 (gjashtëdhjetë) pikë